



Qendra për Drejtësi Gjinore në Shqipëri

TERMA REFERENCE

Koordinator i Qendrës Ditore për Fëmijë dhe të Rinj me Aftësi të Kufizuara

Organizata	Qendra për Drejtësi Gjinore në Shqipëri
Adresa:	Rr. "Nikolla Tupe", P. 2/4, Ap. 15, Tiranë, Shqipëri.
E-mail:	genderjusticealbania@gmail.com
Pozicioni i punës së kërkuar:	Koordinator i Qendrës Ditore për Fëmijë dhe të Rinj me Aftësi të Kufizuara
Lloji i kontratës:	Kohë e plotë
Periudha e kontraktimit:	Prill – Dhjetor 2025
Data e mundshme e fillimit të punës:	01/04/2025
Zona gjeografike:	Bashkia Vlorë
Afati i dorëzimit të aplikimit:	21/03/2025

1. HYRJE

Qendra për Drejtësi Gjinore në Shqipëri (QDGJSH) është një organizatë jofitimprurëse, e pavarur, jo-politike, e cila punon për fuqizimin e grave dhe vajzave, mbron të drejtat e tyre dhe lufton pabarazitë gjinore. QDGJSH është themeluar me iniciativën e tre grave aktiviste të shoqërisë civile të cilat, prej më tepër se 15 vitesh, kontribuojnë në fushën e mbrojtjes së të drejtave të grave në Shqipëri. QDGJSH është regjistruar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë me vendimin nr. 1738, datë 28/06/2022. Sipas legjislacionit në fuqi, QDGJSH është regjistruar edhe pranë Drejtorisë Rajonale të Tatimeve, Tiranë me nr. NIPT: M22002451K.

QDGJSH po zbaton në Bashkinë Vlorë projektin “Ofrimi i shërbimeve të specializuara të kujdesit social për fëmijët, të rinjtë me aftësi të kufizuara dhe prindërit e tyre në Bashkinë Vlorë”, në kuadër të programit “BE për Kujdesin Social”, financuar nga Bashkimi Evropian, zbatuar nga UNICEF Shqipëri dhe Eorl Vision Shqipëri, në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Qendra për Drejtësi Gjinore në Shqipëri

Rr. "Nikolla Tupe", P. 2/4, Ap. 15, Tiranë, Shqipëri

Web: www.gjalbania.org; email: genderjusticealbania@gmail.com; Tel: +355692667531



Qendra për Drejtësi Gjinore në Shqipëri

Në kuadër të projektit, QDGJSH po asiston bashkinë Vlorë për të ngritur një Qendër Ditore për ofrimin e shërbimeve të kujdesit social për fëmijë dhe të rinj me aftësi të kufizuara dhe po kërkon të punësojë një Koordinator për Qendrën Ditore për Fëmijë dhe të Rinj me Aftësi të Kufizuara.

2. DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË KRYESORE

- Menaxhimi i Qendrës Ditore për Fëmijë dhe të Rinj me Aftësi të Kufizuara;
- Identifikimi dhe vlerësimi i nevojave të përfituesve që do të përfshihen në projekt (në bashkëpunim me stafin social të Qendrës Ditore);
- Ndjekja dhe mbarëvajtja e ofrimit të shërbimeve nga specialistët në Qendrën Ditore;
- Planifikimi dhe organizimi i aktiviteteve të projektit;
- Përgatitja dhe mirëmbajtja e dokumentacionit të nevojshëm sipas kërkesave të organizatës dhe donatorit;
- Koordinimi i komunikimit dhe bashkëpunimi me partnerët dhe palët e tjera të përfshira në projekt;
- Hartimi i raporteve periodike mbi progresin e projektit;
- Organizimi i takimeve, trajnimeve dhe aktiviteteve të tjera të projektit;
- Monitorimi i impaktit të projektit dhe sugjerimi i përmirësimeve sipas nevojës;
- Sigurimi që të gjitha aktivitetet të organizohen në përshatje me rregulloret dhe standardet e Qendrës për Drejtësi Gjinore.

3. KUALIFIKIME DHE AFTËSI TË KERKUARA

- Diplomë universitare, preferohet në degën psikologji ose punë sociale;
- Eksperienca të mëparshme pune me grupet vulnerabël (preferohen eksperienca me fëmijë dhe të rinj me aftësi të kufizuara dhe në bashkëpunim me organizata të shoqërisë civile);
- Motivim dhe fleksibilitet me ngarkesën e punës;
- Zotërimi i aftësive shumë të mira komunikuese.

4. PROCESI I APLIKIMIT

Aplikantët e interesuar duhet të dërgojnë me shkrim në adresën elektronike ose adresën postare të Qendrës për Drejtësi Gjinore dokumentacionin e poshtëshënuar:

- Curriculum Vitae (përfshirë referenca të punëdhënësve të mëparshëm);
- Dokumenta që vërtetojnë edukimin (kopje e diplomës universitare, master, etj.);
- Letër motivimi.

Qendra për Drejtësi Gjinore në Shqipëri

Rr. "Nikolla Tupe", P. 2/4, Ap. 15, Tiranë, Shqipëri

Web: www.gjalbania.org; email: genderjusticealbania@gmail.com; Tel: +355692667531



Qendra për Drejtësi Gjinore në Shqipëri

Adresë elektronike: genderjusticealbania@gmail.com; adena.vangjeli@gjalbania.org

Adresë postare: Rr. "Nikolla Tupe", P. 2/4, Ap. 15, Tiranë, Shqipëri.

5. AFATET

Afati për dërgimin e aplikimeve: 21/03/2025.

Adena Vangjeli

Drejtoreshë Ekzekutive
Qendra për Drejtësi Gjinore në Shqipëri

Qendra për Drejtësi Gjinore në Shqipëri

Rr. "Nikolla Tupe", P. 2/4, Ap. 15, Tiranë, Shqipëri

Web: www.gjalbania.org; email: genderjusticealbania@gmail.com; Tel: +355692667531